



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0138
Data e Vendimit: 17.03.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2020 pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gentian Sakaj” B.I. kundër vendimit për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve zyrtare” me numër të prokurimit 624-24-10935-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Suharekës, U.D Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së, me datën: 14.03.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si palejuar, ankesa e OE “Gentian Sakaj” B.I me nr. të protokollit 2025/0138, e datës 24.02.2025, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve zyrtare” me numër të prokurimit 624-24-10935-2-2-1, i iniciuar nga Komuna e Suharekës, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Komuna e Suharekës që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit: “Mirëmbajtja dhe servisi i automjeteve zyrtare” me numër të prokurimit 624-24-10935-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 24.02.2025, ka pranuar ankesën e OE “Gentian Sakaj” B.I lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare” me numër të prokurimit 624-24-10935-2-2-1, të Komunës së Suharekës në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 31.10.2024, Komuna e Suharekës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar njoftimin për kontratë ndërsa me datën 18.11.2024, ka publikuar Formularin Standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.

Me datën 22.02.2025, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës OE “Zeqir Krasniqi”.

Operatori Ekonomik “Gentian Sakaj” B.I, me 24.02.2025, ka parashtruar ankesë në OSHP Nr. 2025/0138 (Nr. protokolli).

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në këtë procedurë prokurimi nga zyra e pranimi në OSHP, sqarohet se operatori ekonomik nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK por ka parashtruar direkt ankesë në OSHP.

Nga kjo konstatohet se OE ka parashtruar ankesë të palejuar për faktin se sipas nenit 109 të LPP-së operatori ekonomik mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së vetëm pas parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim në Autoritet Kontraktues.

OSHP sqaron se sipas nenit 109 të LPP-së kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Po ashtu, edhe me nenin 64 par 1 në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcaktohet se ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të nxjerrë nga autoriteti kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-se.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë të palejuar sepse nuk ka respektuar dispozitat ligjore të shtjelluara si më lartë, andaj i lejon autoritetit kontraktues – Komuna e Suharekës, të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare” me numër të prokurimit 624-24-10935-2-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Po ashtu zyra për pranimin e ankesave ka konstatuar se ankuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e tarifës me rastin e parashtrimit të ankesës në OSHP tarifë kjo e cila kthehet konform nenit 31 par 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

UD. Udhëheqës i Sekretariatit, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - Gentian Sakaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: